



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:084688
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05494143

KPPP.nr.2561/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “S.A.K.” B.I., emri tregtar N.T.P “ARDI-K”, me seli në fshatin Hodonovc, Komuna e Kamenicës, me NUI: 810340745, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.R. avokat nga Gjilani, kundër debitorit “Andi Group 2004” Sh.P.K., me adresë në Gjilan, rruga “Abdullah Tahiri” nr.170, me NUI: 811291046, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.S. avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.697/22 të datës 14.11.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan, jashtë seancës me datë 22.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Andi Group 2004” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.697/22 të datës 14.11.2022, i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.697/22 të datës 14.11.2022, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: 1. Fatura nr.0027379, e datës 14.03.2022, 2. Fatura nr.0027380, e datës 14.03.2022, 3. Fatura nr.0027381, e datës 14.03.2022, 4. Fatura nr.0027382, e datës 14.03.2022, 5. Fatura nr.0027396, e datës 22.03.2022, 6. Fatura nr.0027397, e datës 22.03.2022, 7. Fatura nr.0027155, e datës 25.03.2022, 8. Fatura nr.0027305, e datës 28.03.2022, 9. Fatura nr: 0027159, e datës 31.03.2022, 10. Fatura nr.0027102, e datës 01.04.2022, 11. Fatura nr: 0027103, e datës 01.04.2022, 12. Fatura nr. 0027313, e datës 04.04.2022, 13. Fatura nr.0027321, e datës 11.04.2022, 14. Fatura nr.0027177, e datës 08.04.2022, 15. Fatura nr. 0027178, e datës 07.04.2022, 16. Fatura nr.0027108, e datës 14.04.2022, 17. Fatura nr.0027326, e datës 18.04.2022, 18. Fatura nr.0027185, e datës 18.04.2022, 19. Fatura nr.0027184, e datës 18.04.2022, 20. Fatura nr.0027190, e datës 21.04.2022, 21. Fatura nr.0027191, e datës 21.04.2022, 22. Fatura nr.0053013, e datës 28.04.2022, 23. Fatura nr.0027200, e datës 25.04.2022, 24. Fatura nr.0053001, e datës 25.04.2022, 25. Fatura nr.0053008, e datës 26.05.2022, 26. Fatura nr.0053019, e datës 29.04.2022, 27. Fatura nr.0053034, e datës 08.05.2022, 28. Fatura nr.0053023, e datës 02.05.2022, 29. Fatura nr.0053022, e datës 02.05.2022, 30. Fatura nr.0053045, e datës 16.05.2022, 31. Fatura nr.0053050, e datës 17.05.2022, 32. Fatura nr.0053049, e datës 17.05.2022, 33. Fatura nr.0053458, e datës 20.05.2022, 34. Fatura nr.0053453, e datës 19.05.2022, 35. Fatura nr.0053468, e datës 27.05.2022, 36. Fatura nr.0053469, e datës 27.05.2022, 37. Fatura nr.0053461, e datës 23.05.2022, 38. Fatura nr.0053078, e datës 24.06.2022, 39. Fatura nr.0053077, e datës 24.06.2022, 40. Fatura nr.0053073, e datës 23.06.2022, 41. Fatura nr.0053067, e datës 20.06.2022, 42. Fatura nr.0053063, e datës 17.06.2022, 43. Fatura nr.0053062, e datës 17.06.2022, 44. Fatura nr.0053054, e datës 13.06.2022, 45. Fatura nr.0053497, e datës 10.06.2022, 46. Fatura nr.0005502, e datës 06.06.2022, 47. Fatura nr.0053484, e datës 02.06.2022, 48. Fatura nr.0053485, e datës 02.06.2022, 49. Fatura nr.0053489, e datës 03.06.2022, 50. Fatura nr.0053488, e datës 03.06.2022, 51, Fatura nr.0053478, e datës 31.05.2022, 52, dhe Fatura nr.0053474, e datës 30.05.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 5,805.46 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % në vit, nga dita e dorëzimit të këtij propozimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar lejimin e propozimit për përmbarim, për shkak se ky propozim është bërë vetëm në bazë të faturave të shënuara në propozim, por këto fatura nuk i janë bashkangjitur propozimit si provë, dhe vlera e tyre nuk përputhet me kartelën financiare të debitorit dhe me kushtet e kontratës e aneksit të kontratës së lidhur mes kreditorit dhe debitorit, pra është në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së. Më tej ka theksuar se duke u bazuar në kartelën financiare të debitorit, shihet se debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme ndaj kreditorit dhe se borxhi real i debitorit ndaj kreditorit nuk është si e ka kërkuar në propozimin për përmbarim. Ka shtuar se faturat e paraqitura në propozim nuk janë reale në shumat e tyre, ngase nuk është bërë fare zbritja konform kontratës, përkatësisht ankes kontratës në mes të kreditorit dhe debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit ndërsa të ndalohet në tërësi urdhri për përmbarim i Përmbauesit Privat, si dhe të anulohen veprimet e kryera. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën prej 312.00 Euro.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka deklaruar se obligimi sipas faturave ka qenë 6,715.78 Euro, për furnizim, ku nga kjo shumë debitori ka paguar vetëm shumën prej 910.32 Euro, ndërsa si obligim i mbetur për pagesë është shuma prej 5,805.46 Euro, ndërsa debitori nuk e ka argumentuar me asnjë provë në prapësim se obligimi është më i vogël, apo se ka paguar ndonjë vlerë tjetër siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së. Lidhur me pretendimin e debitorit për zbritjen e shumës së secilës faturë konform kontratës, kreditori ka theksuar se nga kontrata për furnizim Nr.001/21 e datës 24.08.2021, shihet se është Marrëveshje për Obligimin e vjetër deri me datë 31.12.2021, ndërsa faturat me të cilat është inicuar propozimi për përmbarim të gjitha janë të vitit 2022. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të vërtetohet si i bazuar lejimi i propozimit për përmbarim, si dhe të detyrohet debitori që t'i paguajë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208 Euro, sipas TOAK-së, lidhur me numrin tarifor 9.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm/faturat dhe atë : : 1. Fatura nr.0027379, e datës 14.03.2022, 2. Fatura nr.0027380, e datës 14.03.2022, 3. Fatura nr.0027381, e datës 14.03.2022, 4. Fatura nr.0027382, e datës 14.03.2022, 5. Fatura nr.0027396, e datës 22.03.2022, 6. Fatura nr.0027397, e datës 22.03.2022, 7. Fatura nr.0027155, e datës 25.03.2022, 8. Fatura nr.0027305, e datës 28.03.2022, 9. Fatura nr: 0027159, e datës 31.03.2022, 10. Fatura nr.0027102, e datës 01.04.2022, 11. Fatura nr: 0027103, e datës 01.04.2022, 12. Fatura nr. 0027313, e datës 04.04.2022, 13. Fatura nr.0027321, e datës 11.04.2022, 14. Fatura nr.0027177, e datës 08.04.2022, 15. Fatura nr. 0027178, e datës 07.04.2022, 16. Fatura nr.0027108, e datës 14.04.2022, 17. Fatura nr.0027326, e datës 18.04.2022, 18. Fatura nr.0027185, e datës 18.04.2022, 19. Fatura nr.0027184, e datës 18.04.2022, 20. Fatura nr.0027190, e datës 21.04.2022, 21. Fatura nr.0027191, e datës 21.04.2022, 22. Fatura nr.0053013, e datës 28.04.2022, 23. Fatura nr.0027200, e datës 25.04.2022, 24. Fatura nr.0053001, e datës 25.04.2022, 25. Fatura nr.0053008, e datës 26.05.2022, 26. Fatura nr.0053019, e datës 29.04.2022, 27. Fatura nr.0053034, e datës 08.05.2022, 28. Fatura nr.0053023, e datës 02.05.2022, 29. Fatura nr.0053022, e datës 02.05.2022, 30. Fatura nr.0053045, e datës 16.05.2022, 31. Fatura nr.0053050, e datës 17.05.2022, 32. Fatura nr.0053049, e datës 17.05.2022, 33. Fatura nr.0053458, e datës 20.05.2022, 34. Fatura nr.0053453, e datës 19.05.2022, 35. Fatura nr.0053468, e datës 27.05.2022, 36. Fatura nr.0053469, e datës 27.05.2022, 37. Fatura nr.0053461, e datës 23.05.2022, 38. Fatura nr.0053078, e datës 24.06.2022, 39. Fatura nr.0053077, e datës 24.06.2022, 40. Fatura nr.0053073, e datës 23.06.2022, 41. Fatura nr.0053067, e datës 20.06.2022, 42. Fatura nr.0053063, e datës 17.06.2022, 43. Fatura nr.0053062, e datës 17.06.2022, 44. Fatura nr.0053054, e datës

13.06.2022, 45. Fatura nr.0053497, e datës 10.06.2022, 46. Fatura nr.0005502, e datës 06.06.2022, 47. Fatura nr.0053484, e datës 02.06.2022, 48. Fatura nr.0053485, e datës 02.06.2022, 49. Fatura nr.0053489, e datës 03.06.2022, 50. Fatura nr.0053488, e datës 03.06.2022, 51. Fatura nr.0053478, e datës 31.05.2022, dhe 52. Fatura nr.0053474, e datës 30.05.2022, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky që vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2561/22, me datë 22.03.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.